



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2985/40 Prot.

Vlorë më, 20 . 11 .2025

VENDIM

Nr. 110, datë 20 / 11 / 2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.32, DATË 05.07.2021 "PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËSSË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË II-TË "MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI"; DHE VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR. 38, DATË 06.07.2023 "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.32, DATË 05.07.2021 "PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËSSË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË II-TË "MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI"

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të diplomave ose certifikatave për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Urdhërin e MAS me Nr.373, datë 14.07.2023, shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike me nr. ____ prot datë ____/ ____/2025; Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për një ndryshim në formatin e Diplomës së Programit të Integruar të Ciklit të II-të "Master i Shkencave në Drejtësi".
2. Në pikën 1 të Vendimit të Senatit Akademik nr. 32, datë 05.07.2021 (Elementet tekst të formatit) të shtohet dhe pika me elementitn DIPLOMË
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Humane, Zëvendësrektori Akademik dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike
4. Bashkëlidhur formati i diplomave.
5. Ky vendim sëbashku me formatin e diplomave të miratuara përcillet në QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 1 nga 1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1321 / Prot. 6

Vlorë, më 07.07.2023

VENDIM

Nr. 38, datë 06.07.2023

PËR


NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.32, DATË 05.07.2021 "PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS SË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT II "MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI", I NDRYSHUAR.

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimi nr.10, datë 30.03.2020, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga IAL-të dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin e diplomave ose certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", ndryshuar me Udhëzimin e MAS nr.5, datë 03.03.2021 dhe Udhëzimin e MAS me nr.14 datë 21.06.2022, si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1221prot, datë 21.06.2023, Senati Akademik në mbledhjen e dates 06.07.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Zëvendësrektorit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për disa ndryshime në formatin e diplomës për Programin e Integruar të Ciklit II "Master i Shkencave në Drejtësi" si më poshtë:
 - a. Në pikën 2
 - **Zëvendësohet**-emërtimi "Diplomë e Integruar" me "Master i Shkencave".
 - b. Në pikën 3,
 - **Zëvendësohet**- "Diplomë e studimeve të Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi" me "në Drejtësi për programin e Integruar të Ciklit të Dytë"(Agusta Regular 18).
 - c. Në pikën 6,
 - **Ndryshon** lloji i shkrimit nga (Microsoft Sans Serif 12) në (Berlin Sans FB Demi Bold 12).
 - d. Në pikën 7,
 - **Ndryshon** lloji i shkrimit nga (Microsoft Sans Serif 11) në (Berlin Sans Regular 10).
 - e. Në pikën 9.
 - **Ndryshon** lloji i shkrimit nga (Microsoft Sans Serif 10) në (Berlin Sans FB Regular 11).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

f. Në pikën 10.

- **Hiqet**- "Data e regjistrimit në Institucion për programin përkatës".
 - **Zëvendësohet**- "ID e Maturës Shtetërore" me "ID e Maturës Shtetërore/Nr. i Njvlefshmërisë së diplomës (Nr. i regjistrimit)"
 - **Hiqet** - "Nr. i regjistrimit të veçantë"
 - **Zëvendësohet**- "Forma e studimit" me "Forma e studimeve"
 - **Shtohet** - "Kohëzgjatja normale e programit të studimit"
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Zëvendësrektori Akademik dhe Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I dhe të II të studimeve.
3. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi formati i diplomës me ndryshimet e mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. ROLAND ZISI

